



Stafi i FMN-së përfundoi Misionin e Nenit IV për vitin 2021 në Kosovë

PËR PUBLIKIM TË MENJËHERSHËM


Kumtesat për shtyp në përmbyllje të misionit përfshijnë deklaratat e ekipeve të stafit të FMN-së që përcjellin gjetjet paraprake pas vizitës në vend. Mendimet e shprehura në këtë deklaratë janë të stafit të FMN dhe nuk paraqesin medoemos mendimet e Bordit Ekzekutiv të FMN. Bazuar në gjetjet preliminare të këtij misioni, stafi do të përgatitë një raport i cili, nëse merr aprovimin e menaxhmentit, do të prezantohet para Bordit Ekzekutiv të FMN për diskutim dhe vendimmarrje.

- Lëvizshmëria e rikuperuar, veprimet e politikave dhe mbështetja nga diaspora ishin arsyt krye prapa rimëkëmbjes së fortë ekonomike më 2021.
- Presim që rritja të normalizohet në vitin 2022, edhe përkundër rreziqeve ende të larta të pandemisë.
- Si prioritete të politikave përfshin, buxheti duhet të jetë më në favor të rritjes dhe duhet të sigurohet pavarësia e bankës qendrore.

Uashington - 5 nëntor 2021: Një mision i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), i udhëhequr nga z. Gabriel Di Bella, zhvilloi një vizitë virtuale nga 20 tetori deri më 4 nëntor, në kontekst të konsultimeve të Nenit IV të vitit 2021. Në përmbyllje të vizitës, misioni nxori këtë deklaratë:

Lëvizshmëria e rikuperuar, veprimet e politikave dhe mbështetja nga diaspora ishin arsyt krye prapa rimëkëmbjes së fortë ekonomike më 2021

Pas një tkurrjeje prej 5.3 për qind më 2020, BPV-ja reale e Kosovës parashikohet të rritet për 7 - 8 për qind në vitin 2021, si pasojë e ripërtëritjes së lëvizshmërisë së brendshme dhe mbështetjes së jashtëzakonshme nga diaspora. Krahasuar me nivelet para pandemisë, remitancat në 8-mujorin e parë të vitit 2021 u rritën me rreth 40 për qind, ndërsa eksportet e shërbimeve, që përfshijnë turizmin nga diaspora, u rritën me 15 për qind. Nga ana tjetër, programi i suksesshëm i vaksinimit të qeverisë kontribuoi në përfitimet e lëvizshmërisë, ku Kosova kishte shkallën më të lartë të vaksinimit në Ballkanin Perëndimor në fund të tetorit (47 për qind). Rekomandohet vazhdimi i këtij programi në vitin 2022, i financuar përmes një ndarjeje buxhetore për të siguruar vaksina shtesë përforcuese dhe për ta rritur tutje mbulueshmërinë.



Presim një kontribut domethënës të politikave të qeverisë në rimëkëmbjen ekonomike të këtij viti:

- **Përderisa politikat fiskale do të jenë më pak mbështetëse sesa më 2020, veprimet e marra përmes politikave ishin ndihmesë e madhe për ekonomitë familjare dhe bizneset e cenueshme dhe mbështetën formalizimin ekonomik.** Rikthimi ciklik i të hyrave, kufizimet fiskale dhe realizimi i ulët i buxhetit për investime (pjesërisht për shkak të mungesës së bordit funksional në Organin Shqyrtues të Prokurimit, OSHP) do të çojnë në një pozicion fiskal pothuajse të balancuar në vitin 2021, krahasuar me deficitin që ishte afër 8 për qind e BPV-së vitin e kaluar.
- **Nga ana tjetër, politikat financiare kanë lejuar vazhdimin e rrjedhës së kredive.** Zgjatja e afatit për ristrukturimin e kredive në fillim të vitit 2021, kombinuar me pritjet e përmirësuar, çoi në rritje më të madhe kreditore, e cila, pas një ngadalësimi në vitin 2020, parashikohet të zgjerohet me më shumë se 10 për qind (v/v) në vitin 2021.

Inflacioni do të rritet në rreth 5 për qind (v/v) deri në fund të vitit 2021, për shkak të çmimeve më të larta të energjisë dhe ushqimeve. Përderisa kërcimi në çmime të naftës shpjegoi rreth ½ e rritjes në gjysmën e parë të vitit 2021, përsheptimi i rritjes së çmimeve të ushqimeve kontribuoi në inflacion gjatë verës. Gjersa ekonomitë familjare deri më tani kanë mbetur të izoluar nga rritja e madhe e çmimeve të energjisë elektrike në Evropë, disa kompani janë prekur përmes ekspozimit të tyre në tregun rajonal të energjisë elektrike. Ndonëse ndikimet e raundit të dytë nuk janë ende të forta, inflacioni bazë ka filluar të rritet. Ne presim që presionet e inflacionit të mbeten të qëndrueshme deri në mes të vitit 2022 dhe gradualisht të zbuten më pas.

Spektori bankar mbetet përgjithësisht i qëndrueshëm. Nivelet e kapitalit dhe likuiditetit janë të fortë si dhe kreditë joperformuese janë në nivel të ulët, ndonëse përmirësimi i shumë treguesve të shëndetit financiar është pjesërisht i lidhur me reagimin e politikave ndaj pandemisë. Përkundër mungesës së rreziqeve sistematike, ka cenueshmëri të caktuara që lidhen me rritjen e shpejtë të kredidhënies për sektorin e ndërtimit nga bankat më të vogla.

Perspektiva: Rritja për normalizim mes rreziqeve ende të larta të lidhura me pandeminë

Në mungesë të surprizave negative të lidhura me pandeminë, presim që BPV-ja reale të rritet me 3-4 për qind më 2022, pjesërisht e nxitur nga lëvizjet e forta ekonomike të këtij viti. Aktiviteti ekonomik do të mbështetet edhe nga zgjerimi i vazhdueshëm i kredive vendore dhe lehtësimet e politikave fiskale, ndonëse madhësia e kësaj të fundit do të varet nga kapaciteti për të rritur absorbimin e projekteve investuese të financuara nga jashtë dhe emërimi i drejtorëve në Bordin e OSHP-së nga ana e Kuvendit. Rritja e shpejtë e rasteve në muajin gusht është kujtesë se mutacionet e reja të virusit vazhdojnë të jenë rreziku kryesor negativ. Në këtë drejtim, kapaciteti ende i ulët i spitaleve mund të rezultojë në nevojën për të rivendosur kufizime të lëvizshmërisë, nëse rastet rriten përsëri. Nga ana pozitive, zbatimi i një programi ambicioz të masave qeveritare mund të shpie në rritje më të lartë, bashkë me vazhdimin e mbështetjes së jashtëzakonshme të diasporës, që parashikohet të jetë paksa më e ulët në bazën tonë.

Prioritetet e politikës fiskale: Të sigurohet që buxheti favorizon rritjen

Të hyrat e papritura fiskale të siguruara nga diaspora duhet të shfrytëzohen për t'i mbyllur zbrazëtirat e infrastrukturës sociale dhe ekonomike, si dhe për t'i diversifikuar

motorët e rritjes. Ndonëse forca e rimëkëmbjes së vazhdueshme ekonomike sugjeron që politika fiskale duhet t'i rikthehet rregullit fiskal duke filluar nga viti 2022, buxheti duhet të përfshijë një ndarje për shpenzime emergjente, në rast të rikthimit të virusit. Për më tepër, rimbushja e plotë e rezervës fiskale do t'i ofronte mundësi inicimit të procesit të marrjes së një rejtingu të letrave me vlerë të borxhit publik të Kosovës, gjë e cila me kalimin e kohës do të mund të zgjeronte madhësinë dhe likuiditetin e tregut të borxhit publik. Nga ana tjetër, buxheti që favorizon rritjen kërkon përmirësim të përbërjes, efektivitetit dhe efikasitetit të shpenzimeve. Në këtë aspekt:

- **Fatura e pagave duhet të mbetet brenda kufirit ligjor.** Projektligji i ri që rregullon pagat publike duhet ta forcojë transparencën dhe drejtësinë në kompensim, por të bazohet në koeficientë të pagave që nuk rrisin në mënyrë të paqëndrueshme faturën totale të pagave.
- **Programet e reja të transfereve sociale duhet të projektohen mirë, të jenë të targetuara dhe transparente.** Buxheti për vitin 2022 mund ta qartësojë dizajnin dhe përfituesit e synuar të programeve të parashikuara për zgjerimin e përfitimeve për fëmijë dhe transfereve për nënat e papuna prej 0.6 për qind të BPV-së si dhe shfrytëzimin e prituri të ndarjes së përgjithshme për subvencione dhe transfere prej 1.6 për qind të BPV-së. Duhet të finalizohet certifikimi i veteranëve të luftës dhe ndarja buxhetore për përfitimet e veteranëve të luftës duhet të izolohehet nga rritja e pritshme e pagës minimale.
- **Duhet të rritet kapaciteti i sistemit shëndetësor, të rritet qasja në kompjuterë në shkolla dhe ekonomi familjare, si dhe të caktohet një ndarje për të rritur numrin e gjykatave komerciale, siç kërkohet me projektligjin që aktualisht është në diskutim.** Përderisa siguria, mbrojtja dhe infrastruktura rrugore përbëjnë një pjesë të madhe të buxhetit për investime, rreziqet negative kërkojnë që të dedikohen burime të targetuara për të rritur përqindjen e ekonomive familjare dhe shkollave me qasje në kompjuterë dhe për të zgjeruar infrastrukturën spitalore. Nga ana tjetër, për t'i mbajtur dhe konsoliduar arritjet e kohëve të fundit në formalizim të aktiviteteve ekonomike, ka nevojë për gjykata komerciale më të shpejta dhe më efektive si dhe angazhim të vazhdueshëm në përmirësimin e politikës tatimore dhe administrimit tatimor, si dhe rritje të pagesave elektronike.
- **Reduktimi i ndotjes dhe emetimeve kërkon prodhim më të pastër të energjisë elektrike.** Vendosja e filtrave në Kosovën B, në bashkëpunim me BE-në, mbetet prioritet në këtë fushë.

Prioritetet e politikës financiare: Sigurimi i pavarësisë së Bankës Qendrore

E ritheksojmë urgjencën e plotësimit të vendeve të zbrazëta në Bordin e Bankës Qendrore (BQK). Kjo është thelbësore, në mënyrë që BQK-ja të miratojë buxhetin e saj, t'i mbikëqyrë politikën e saj dhe t'i zbatojë reformat e nevojshme, duke përfshirë që të sigurojë që stabiliteti financiar dhe funksionet e politikës makroprudenciale përfaqësohen në mënyrë adekuate në Bordin Ekzekutiv të BQK-së.

Duke pasur parasysh nivelin komod të rezervës fiskale, ndarja e re e SDR (Special Drawing Rights - të drejtat speciale të tërheqjes) mund të përdoret për ta forcuar hapësirën e BQK-së për Asistencë të Huadhënies Emergjente (ELA). Kjo është e rëndësishme meqë madhësia aktuale e ELA-së është shumë e ulët në krahasim me rreziqet e mundshme të likuiditetit të sektorit financiar. Megjithatë, ndarja e SDR-së duhet të mbetet në dispozicion për mbështetjen e lidhur me pandeminë, në rast se materializohen rreziqet negative.

Meqë masat mbështetëse të lidhura me pandeminë janë larguar gradualisht më 2021, duhet të forcohet monitorimi i rrezikut kreditor. Kjo do të siguronte që provizionimi reflekton rritjen bazë të rreziqeve të solvencës dhe se rezervat e kapitalit janë të mjaftueshme për t'i absorbuar zhvlerësimet dhe për ta mbajtur rrjedhën e kredisë. Në këtë drejtim, BQK-ja duhet të vazhdojë ta zhvillojë kapacitetin e saj për t'i analizuar rreziqet e bankave në kontekst të kalimit në SNRF9.

"Misioni dëshiron t'i falënderojë autoritetet dhe të gjitha palët e tjera për dialogun e sinqertë, të hapur dhe konstruktiv."